



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:223108

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05715543

P. nr.1160/2023

NE EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore-Departamenti i pergjithshem Penal në Prizren, me gjyqtarin gjykues Fatmir Krasniqi, dhe sekretares juridike Fatime Bajraktari, në çeshtjen penale kundër të akuzuarit **B.B.**, nga Arbana-Prizren, për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 185 par.3 nenpar.3.1 lidhur me par.1 nenpar.1.4 të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore të shtetit në Prizren PP/II nr.1937-11/2023 të dt.06.11.2023, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar gjyqësor, në prezencën e Prokurorit Themelor të shtetit në Prizren, Atnor Skoro, të akuzuarit, të demtuareve me perfaqësuesit e tyre ligjor, mbrojtjes së viktimave, me datë **30.04.2024** morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B.B.**, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur menë Prizren, tani me banim në Arbane-Prizren, në rr.Beteja e Pashtrikut pnr, i martuar, punëtor, shkollën fillore 2 vite të kryer, i gjendjes së dobët ekonomike, ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, nr.pers.

ËSHTË FAJTOR

Se më 18.10.2023, rreth 18:30^{min} në shtëpinë e përbashkët familjare e cila gjendet në rr. “ Beteja e Pashtrikut “, Lagjja Arbana në Prizren, i pandehuri B.B., me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuarve – motrave të tij A.B., dhe B.B., , të cilat janë viktime të ndjeshme, për shkak të raporteve familjare, në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme familjare që kanë mes veti, derisa të dëmtuarat e lartpërmendura ishin duke qëndruar në dhomë, i pandehuri kërkon nga e dëmtuara A. B., që të sjell një troleks për pastrim të dhomës e cila nuk ia sjell, më pas i pandehuri e sulmon fizikisht të dëmtuarën duke e kap për flokë dhe godet me grushte në anën e majtë të fytyrës dhe përreth syrit të majtë, ndërsa në ato momente ndërhyjnë e dëmtuara B. B., i cili edhe të njëjtën e sulmon fizikisht duke ia përdredh dorën e djathtë, dhe si rrjedhojë e sulmit fizik të dëmtuarat A. B., pëson ndrydhje të indeve të buta në regjionin e fytyrës dhe regjionin përreth syrit të majtë, kurse B. B., pëson ndrydhje të indeve të buta në regjionin e dorës së djathtë, të cilat dëmtime janë shkaktuar nga veprimi mekanik të mjetit të

fortë, mbrretës (jo i mprehtë) dhe si të tilla kualifikohen lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën.par. 3.1 lidhur me par.1, nën.par.1.4 i Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës (më tutje: KPRK-së)

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72, dhe nenit 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KP-së, si dhe nenit 364 të KPPK-ës, te akuzuarin e :

GJYKON

DËNIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 5 /pesë/ muajve, i cili denim me burgim do te ekzekutohet pas plotefuqisjmerise se ketije aktgjykimi.

Duke aplikuar nenin 3 par.2 te KP-se, dhe nenin 44 te KP-se, me propozimin dhe pelqimin e te akuzuarit kerkone qe denimi i shqiptuar me burgim ne kohezgjatje prej 5 /pesë/ muajve, ti zevendsohet me denim me gjobë. Gjykata denimin me burgim ne kohezgjatje prej 5 /pesë/ muajve, i zevendsoi ne denim me gjobe në shumën prej **500,00 € (peseqinde) Euro**, të cilën shume te denimit eshte i obliguar ta paguaj në afat prej 30 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i akuzuari denimin me gjobe do ta paguaje ne 5 kiste, ne rast te mospageses as me ekzekutim i njeiti denim me gjobe do te zevendsohet ne denim me burgim ashtu qe do te llogaritet per qdo 20 euro llogaritet 1 dite burgim respektivisht 25 dite burgim

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet gjyqësore të procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej **20 euro**, dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit në shumën prej **20 euro**, në emër të ekspertizes mjeko-ligjore shumën prej **50 eurove**, në afat prej **15 ditëve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritë aktakuzë PP/II nr. 2002-11/2022 të dt.06.02.2023, kundër të akuzuarit Shqipron Lushaj nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KP-së.

Gjykata ne shqyrtim fillestar ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit e cila vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesis per veprat penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajesis eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardh ne perfundim, se pranimi i fajesise nga

ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 242 par.1 e 2 nenpar.2.1, 2.2, 2.3, 2.4 te KPPK-se, dhe faktet qe permban akuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale, te lendimit te lehte trupor nga 185 par.3 nenpar.3.1 lidhur me par.1 nenpar.1.4 të KP-së, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuares gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 69 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, ne kuptim te nenit 70, 71 e 72 te KP-es, gjykata morri per baze edhe faktin se e akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tije ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale, ka pranuar fajesin vullnetshem, pa presion e as pa ndikim nga jashte, i premtonte gjykatës se ne te ardhmen nuk do te perserise vepra te ketille penale, si rrethane posaqerishte lehtesuese eshte marre pranimi vullnetar i fajesise, veprimi ka qene i qastit dhe nuk ka qene sa duhet i kujdesshem per kete veper penale, kerkim falje publike te demtuareve-motrat e tije me te cilat sot edhe bashkejeton ne te njejten shtepi, dhe premtimi se nuk do te perserise me asnjeher keso vepra penale, andaj gjykata me aplikimin e nenit 44 te KP-se, me pelqimin e te akuzuarit, denimin me burgim i ka zevendsuar ne denim me gjobe, sepse konsideron se me shqiptimin edhe te ketije lloji denimit me gjobe, do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tije, dhe me kete do te ndikojte te i akuzuari qe ne te ardhmen te jete i kujdesshem dhe te permbahet nga veprimet e tilla te karakterit juridiko-penal.

Vendimi mbi për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 452 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga të cekurat më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i pergjithshem Penal
P.nr.1160/2023 të dt.30.04.2024

Sekretare juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi palët e pakënaqura kane te drejtë ankese në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes se te njëjtës, Gjykatës se Apelit ne Prishtine, e nëpërmjet te kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:223108
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05715543